



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 korrik 2013  
Nr. ref.:VTK 466/13

**VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA**

**në**

**Rastet KI58, KI66 dhe KI94/12**

Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunalë të KK të Vitisë

**Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Komunës së Mitrovicës, Gjilanit dhe Vitisë për kushtëzimet e qytetarëve në qasje në shërbimet komunale me pagesën e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Cukalovic, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama, gjyqtare

## **Parashtruesit e kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë: Selatin Gashi nga fshati Busi i komunës së Mitrovicës, Halit Azemi, banues në Sheshin e Pavarësisë të qytetit të Gjilanit dhe grupi i këshilltarëve komunalë të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Vendime të kontestuara të autoriteteve publike janë:
  - 1) Vendimet e Kuvendit të Komunës–Mitrovicë Nr.02/06-22557/8 të 26 prillit 2012 dhe Vendimi Nr 02/06-3401/5 i 7 korrikut 2011 për kushtëzimin e qytetarëve dhe bizneseve me seli në KK-Mitrovicë në qasjen ndaj shërbimeve komunale me dëshminë e pagesës së obligimeve ndaj KRU "Mitrovica" dhe KRM "Uniteti".
  - 2) Vendimi i KK-Gjilan 01 Nr.16/10608 i 24 qershorit 2011 për kufizimin e shërbimeve të Komunës me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë dhe iu dedikohet të gjithë personave juridikë e fizikë të komunës së Gjilanit, dhe
  - 3) Vendimi 01/013/1355 i 29 korrikut 2011 i KK-Viti për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë, i cili gjithashtu vlen për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të komunës së Vitisë.

## **Objekti i çështjes**

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 15 qershor 2012 (KI 58/12), më 9 korrik 2012 (KI 66/12) dhe 24 dhjetor 2012 KI 94/12) është vlersimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të KK të Mitrovicës, KK të Gjilanit dhe KK të Vitisë, me anë të të cilave kushtëzohen personat juridikë dhe fizikë të këtyre komunave që shërbimet e caktuara komunale të cekura në vendime nuk mund t'i gëzojnë nga administratat respektive komunale nëse më parë nuk paraqesin si dëshmi faturat për kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike të cekura në vendime dhe atë ndaj: KRU "Mitrovica" dhe KRM "Uniteti", në KK Mitrovicë, ndaj ndërmarrjeve publike kompetente për ujë dhe mbeturina në KK Gjilan (pa i cekur emrat në vendim) dhe KRM "Higjena" SHA-Gjilan dhe KRU "Hidromorava" SHA-Gjilan (KK-Viti).

## **Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese**

4. Parashtruesit e kërkesave kanë pretenduar se me vendimet e kuvendeve komunale të cekura në paragrafin e dytë të këtij vendimi u janë shkelur të drejtat e njeriut si në vijim:
  - a) Neni 21.1, neni 24 (1) dhe 124 (6) i Kushtetutës (z. Selatin Gashi kërkesa KI 58/12).
  - b) Z. Halit Azemi (Kërkesa KI 66/12) nuk kishte cekur ndonjë dispozitë kushtetuese, por ka theksuar se janë shkelur të drejtat e njeriut në marrjen e dokumenteve personale.
  - c) Këshilltarët komunalë të KK të Vitisë kanë bashkangjitur vendimin e kontestuar duke kërkuar vlerësimin kushtetues të tij, pa përcaktuar detaje të tjera.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, dhe rregullat 53 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese e renditur kronologjikisht sipas rasteve**

### **Rasti KI 58/12**

6. Më 1 qershor 2012, Gjykata nëpërmes postës pranoi një kërkesë nga z. Selatin Gashi, me anë të së cilës ai kërkonte nga Gjykata që të: "Vlerësojë kushtetutshmërinë e një memorandumi të lidhur më 24 prill 2012 në mes të KK të Mitrovicës në njërën anë si dhe të Ujësjetës Rajonal si dhe të Ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave "Uniteti", në anën tjetër".
7. Më 4 qershor 2012, Gjykata kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës së parë z. Selatin Gashi për procedurën rreth regjistrimit të kërkesës, duke kërkuar nga ai edhe dokumentacion shtesë, ndërsa më 15 qershor 2012, parashtruesi i parë, z. Selatin Gashi paraqiti kërkesën e plotësuar në Gjykatën Kushtetuese duke i bashkangjitur edhe vendimet e kontestuara të Komunës së Mitrovicës. Kërkesa u regjistrua në Gjykatë me nr. KI 58/12.

8. Më 21 gusht 2012, Gjykata kishte njoftuar Kuvendin Komunal të Mitrovicës dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për regjistrim të kërkesës dhe nga të njëjtit kishte kërkuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me këtë çështje, por Komuna e Mitrovicës nuk është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës.
9. Më 16 tetor 2012, z. Selatin Gashi i dërgoi Gjykatës materialin shtesë, me të cilin pretendonte të vërtetojë satusin e “viktimës” në rastin që ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese si pasojë e vendimeve komunale që i konteston.

#### **Rasti KI 66/12**

10. Më 3 korrik 2012, Gjykata nëpërmes postës pranoi një kërkesë nga avokati z. Halit Azemi, me të cilën ai nga Gjykata kërkonte që “vendimin e Komunës së Gjilanit të 24 qershorit 2012, Gjykata Kushtetuese ta shpallë të pavlefshëm dhe joligjor”.
11. Më 4 korrik 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhet ta plotësojë kërkesën dhe ta plotësojë formularin standard të Gjykatës për kërkesat individuale në Gjykatë. Ndërsa më 13 korrik 2012, z. Halit Azemi nga Gjilani paraqiti kërkesën e plotësuar në Gjykatën Kushtetuese dhe e njëta u regjistrua me nr. KI 66/12.
12. Më 29 tetor 2012, Gjykata ka pranuar nëpërmes postës një përgjigje me shkrim nga Komuna e Gjilanit, në të cilën shpjegoheshin arsyet e marrjes së vendimit, i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës si dhe kësaj përgjigjeje i është bashkangjitur edhe dokumentacioni relavant, i cili ka qenë bazë për marrjen e vendimit të Kuvendit Komunal për kushtëzime në qasjen e disa shëebimeve të administratës komunale.

#### **Rasti KI 94/12**

13. Më 24 shtator 2012, Gjykata pranoi nëpërmes postës një kërkesë nga parashtruesi i tretë –Grupi i këshilltarëve të LDK-së nga KK të Vitisë, me të cilën kërkohet: “Përmes kësaj shkrese i drejtohem Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 01-013/1395 i marrë në seancën e mbajtur më 21 prill 2011.”
14. Më 15 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Komunën e Vitisë dhe parashtruesit e kërkesës, Grupin e këshilltarëve të LDK-së në KK të Vitisë, lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe njëkohësisht nga të dyja palët kërkoi të dërgojnë në Gjykatë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës duke përfshirë edhe vendimin e kontestuar si dhe komunikimin me

Ministrinë e Administratës Publike lidhur me këtë çështje, por Gjykata nuk mori ndonjë përgjigje në afatin e kërkuar nga asnjëra palë.

15. Më 31 gusht 2012, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ishte përgjigjur, duke deklaruar që ishte në dijeni për kushtëzimet ndaj qytetarëve në disa komuna të Kosovës dhe së bashku me përgjigjen ka bashkangjitur edhe letrën shpjeguese për kryetarët e komunave ku këto kushtëzime i cilëson si të paligjshme. Duke shtuar se komunat nuk kanë kompetencë ligjore për t'i kushtëzuar qytetarët me kryerjen e obligimeve të tyre ndaj ndërmarrjeve publike.
16. Më 11 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës mori vendimin për bashkimin e lëndëve KI 58/12, Ki 66/12 dhe KI 94 12 në një lëndë të vetme, pasi që kanë objekt të njëjtë shqyrtimi dhe vendosi që gjyqtarja Arta Rama të caktohet Gjyqtare raportuese, ndërsa Kolegji shqyrtues të përbëhet nga: Almiro Rodrigues, kryesues, Alltay Suroy dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës, Ivan Cukalovic, gjyqtarë.
17. Më 18 tetor 2012, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që duke marrë parasysh nevojën për sqarime të mëtutjeshme për çështjen nga palët në procedurë, qartësimin e pozicionit ligjor të MAPL-it si dhe interesin e publikut, të caktohet një seancë publike dëgjimore për çështjen që është objekt shqyrtimi në Gjyaktë dhe ky rekomandim u votua njëzëri, njëkohësisht u caktua që seanca publike dëgjimore të mbahet më 3 dhjetor 2012.

### **Përmbledhja e fakteve**

18. Më 26 prill 2012, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës nxori Vendimin Nr.02/06-22557/8 dhe më 7 korrik 2011 Vendimin Nr 02/06-3401/5 për kushtëzimin e qytetarëve dhe bizneseve me seli në KK të Mitrovicës në qasjen ndaj shërbimeve komunale me dëshminë e pagesës së obligimeve ndaj KRU "Mitrovica" dhe KRM "Uniteti".
19. Vendimet kishin këtë përmbajtje:
  - "1. Me këtë vendim të gjitha bizneset KUSHTËZOHEN" që me rastin e aplikimit për leje për rexhistrim dhe leje të biznesit të tyre, të ofrojnë dëshmi (vërtetim) se i kanë kryer obligimet (borxhet) ndaj KRU "MITROVICA" sh.a."
  - "2. KUSHTËZOHEN ekonomitë familjare që me rastin e regjistrimit të automjeteve, lejeve për ndërtim dhe përkthim të pasurisë së patundshme

të ofrojnë dëshimi (vërtetim) se i kanë kryer obligimet (borxhet) ndaj KRU "MITROVICA".

20. Vendimi i dytë i kishte dy pikat e para tërësisht identike vetëm se në vend të KRU "MITROVICA", obligimet do të duhej t'i përmbusheshin KRM "UNITETI".
21. Më 24 qershor 2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka nxjerrë Vendimin nr.01 Nr.16/10608 për kufizimin e shërbimeve të Komunës me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë.xxx
22. Ky vendim ishte rivotuar në formë dhe përmbajtje të njëjtë edhe në dhjetor të vitit 2012.
23. Vendimi sa i përket çështjes së kontestuar kishte këtë përmbajtje:

Neni 1

"Ky vendim përcakton llojet e shërbimeve komunale që kufizohen nga organet e administratës komunale të Komunës së Gjilanit për shkak të mospagesës së faturave për mbeturina dhe ujë".

Neni 2

"2 Kufizimi i ofrimit të shërbimeve komunale nënkupton mosofrimin e një shërbimi të caktuar nga drejtoritë e Administratës komunale ndaj personit fizik dhe juridik deri, në përmbushjen e detyrimit nga ana e tij".

'.....'

Neni 4

Pika 4. "Taksën për automjetet motorike

24. Parashtuesi i kërkesës, z. Halit Azemi i ishte drejtuar edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtit Lokal (më tej MAPL) më 1 dhjetor 12 2011, por sipas pohimit të tij, nuk kishte marrë përgjigje.
25. Më 29 korrik 7 2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë kishte nxjerrë Vendimin 01/013/1355 për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë, i cili vlen për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të komunës së Vitisë.
26. Vendimi kishte këtë përmbajtje sa i përket pjesës në çështjen që kontestohet:

II

"Kufizimi i ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale nënkupton mosofrimin (moskryerjen) e një shërbimi nga drejtoritë e Administratës

komunale ndaj subjekteve të së drejtës (personave juridikë dhe fizikë) deri në mospërbushjen respektivisht shlyerjen e pjeshme të borxheve ndaj KRM "HIGJENA" SH.A . Gjilan dhe KRU "HIDROMORAVA" SH.A. Gjilan, për shërbimet e kryera nga këto kompani"

"....."

## V

### Paragrafi ( 1 )

"Shërbimet e kufizuara për personat fizikë dhe juridikë shfrytëzues të shërbimeve sipas kushteve nga pika 4 e këtij vendimi, do të zbatohen dhe përfshin:

### Pika 4."taksën për automjetet motorike"

27. Më 20 qershor 2012, MAPL-i ua kishte dërguar letrën shpjeguese të gjithë kryetarëve të komunave të Kosovës dhe në pikën e fundit të kësaj shkrese shpjeguese decidivisht kishte përcaktuar se kushtëzimet e komunave për qasje në shërbime komunale me kryerje të obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike "nuk kanë bazë ligjore dhe si të tilla nuk duhen të aplikohen".
28. MAPL-i më tej shpjegon në këtë shkresë se sipas nenit 128 të Ligjit 02/L123 për shoqëritë tregtare si dhe Ligjit 03/L 087 për shoqëritë aksionare, i cili ka paraparë që shoqëritë aksionare janë përgjegjëse për borxhet e tyre dhe obligimet e tjera dhe përgjigjet për to me të gjitha asetet dhe pasurinë e tyre dhe askush tjetër nuk është përgjegjës për obligimet e shoqërive aksionare".
29. Më 8 gusht 2012, me kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/1395 (Vendimi për kushtëzimin e qytetarëve dhe personave juridikë), MAPL-i kishte kërkuar nga Komuna e Vitisë që vendimin e lartcekur ta harmonizojë me legjislacionin në fuqi në afat prej 30 ditësh, sepse në formën ekzistuese është i paligjshëm.
30. Më 21 gusht 2012, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (më tej KMLDNJ), kushtëzimet e bëra nga disa komuna të Kosovës për marrjen e disa shërbimeve komunale me pagesën e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare e kishte cilësuar si shkelje të të drejtave të njeriut dhe shkelje të nenit 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, duke potencuar se "Neni 29 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht pika 2, shprehimisht thotë: "Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'iu nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj...".

## **Seanca dëgjimore publike**

31. Më 3 dhjetor 2012, Gjykata mbajti seancë publike ku morën pjesë dhe u dëgjuan këto palë:
- a) Parashtresit e kërkesave, z. Selatin Gashi, z. Halit Azemi, parashtresit i kërkesës KI 94/12 (këshilltarët e LDK-së KK Viti), edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, ka munguar;
  - b) Palët kundërshtarë, Komuna e Mitrovicës e përfaqësuar me autorizim nga z. Rrustem Musa, Komuna e Gjilanit e përfaqësuar me autorizim nga z. Bardhosh Dalipi dhe Komuna e Vitisë me autorizim nga z. Agim Sylejmani;
  - c) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në cilësinë e palës së interesuar, e përfaqësuar nga z. Besim Murtezani;
  - d) Institucioni i Avokatit të Popullit, në cilësinë e palës së interesuar, i përfaqësuar nga z. Isa Hasani;
  - e) Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në cilësinë e palës së interesuar, i përfaqësuar nga z. Behxhet Shala.

## **Deklarimet e palëve në seancë**

32. Z. Selatin Gashi në seancën publike deklaroi në mes të tjerash "se vendimi i Kuvedit për të drejtat themelore të tij dhe të qytetarëve të tjerë dhe sidomos atyre që kanë automjete motorike dhe se atij këtë vit, si pasojë e këtij vendimi, i është dashur ta regjistrojë veturën e tij në emër të një shoku me banim në fshat, i cili nuk ka obligime ndaj ujësjellësit dhe kompanisë publike të mbeturinave dhe se veturën e tij personale tash e drejton me autorizim nga personi në emër të cilit e ka regjistruar atë";
33. Z. Halit Azemi ka deklaruar: "Me vendimin e Komunës së Gjilanit janë shkëputur të drejtat themelore të qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe sidomos neni 55 i Kushtetutës, ai gjithashtu ka potencuar se që nga korriku i këtij viti, ndërmarja "Higjena" është privatizuar."
34. Përfaqësuesi i KK të Mitrovicës, z. Musa ka deklaruar se me pranimin e shkresës shpjeguese nga MAPL-i për paligjshmërinë e vendimeve të kuvendeve komunale lidhur me kushtëzimet, ai ka insistuar për shfuqizimin e tyre dhe përfundimisht Kuvendi Komunal ka nxjerrë Vendimin Nr 02/06-4896/11 të 30



tetorit 2012, me të cilin ka bërë shfuqizimin e vendimit për kushtëzimin e qytetarëve, që është objekt shqyrtimi në këtë seancë publike duke e prezentuar para Gjykatës edhe kopjen e vendimit. Ai gjithashtu ka theksuar se pajtohet me konstatimin e palëve se vendimi i Komunës ka qenë joligjor dhe se ai vetë ka votuar kundër tij”.

35. Përfaqësuesi i Komunës së Gjilanit potencoi se ai në tërësi mbetet pranë përgjigjes me shkrim që Komuna e Gjilanit i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese më 29 tetor 2012. Ndërsa në pyetjen e parashtruesit të kërkesës, z. Azemi, pse nuk e ka shfuqizuar vendimin e vet Komuna pas shkresës së MAPL-it, është përgjigjur se “kjo sigurisht është çështje e kohës dhe se vendimi do të shfuqizohet”.
36. Përfaqësuesi i Komunës së Vitisë ka deklaruar “se në kohën kur është marrë vendimi për kushtëzimet, ka qenë një fuqi një ligj tjetër dhe tash ka një ligj tjetër për ndërmarrjet publike dhe se pas shkresës së MAPL-it, ata e kanë shfuqizuar vendimin”.
37. Përfaqësuesi i MAPL-it deklaroi se “pozicioni ligjor i MAPL-it lidhur me vendimet për kushtëzime të qytetarëve me pagesën e faturave për ndërmarrjet publike u është bërë publik kryetarëve të komunave me shkresën shpjeguese të datës ku qartë është thënë se këto vendime nuk kanë bazë ligjore” dhe për më tepër “ne mendojmë se nuk janë as demokratike dhe se prekin sferën e të drejtave të njeriut”.
38. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit deklaroi: “Kushtëzimi i qytetarëve për kufizimin e shërbimeve vetëm në disa komuna i vë në pozitë të pabarabartë këta qytetarë në raport me qytetarët e komunave të tjera, ku këto kufizime nuk janë aplikuar dhe se ata i vë në pozitë të pabarabartë para ligjit, gjithashtu përfaqësuesi i IAP-it theksoi: “Kufizimi i qytetarëve në disa komuna në formën çfarë është bërë, është i papranueshëm dhe i cenon dhe i pakëson të drejtat e njeriut.
39. Përfaqësuesi i KLMDNJ-së në seancën publike ka deklaruar “se me këto vendime kemi të bëjmë me shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, se reagimi ynë publik lidhur me këtë çështje ka dhënë efektin e duhur dhe se reagimi i MAPL-it ka qenë bukur i shpejtë kur e ka dërguar letrën shpjeguese për kryetarët e komunave”.

## **Përmbledhja e fakteve pas seancës dëgjimore**

40. Më 30 prill 2013, Komuna e Gjilanit ka njoftuar zyrtarisht Gjykatën Kushtetuese se në seancën e mbajtur më 23 prill 2013, ka nxjerrë vendimin për shfuqizimin e vendimit për kufizimin e ofrimit të shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë” duke i dërguar nëpërmes postës elektronike zyrtare kopjen e Vendimit 01 nr 16-35734 të 23 prillit 2013.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës dhe i meritave**

41. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata në parim, paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi(it) i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

42. Lidhur me këtë, Gjykata gjithmonë merr për bazë nenin 112.1 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

*1. ‘Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.’*

dhe,

nenin 113.7 të Kushtetutës, kur vlerëson kërkesat individuale, ku përcaktohet se:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*

43. Gjykata me këtë rast merr parasysh edhe rregullin 32 të Rregullores së punës, ku është përcaktuar se

*(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest.*

44. Duke qenë në dijeni për Vendimin e KK të Vitisë të 3 tetorit 2012 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-13/1395 të 9 tetorit 2011, Vendimin e KK të Mitrovicës Nr 02/06-4896/11 të 30 tetorit 2012, me të cilin ka bërë shfuqizimin e vendimit për kushtëzimin e qytetarëve dhe Vendimin e KK të Gjilanit 01 nr 16-35734 të 23 prillit 2013, me të cilin gjithashtu është shfuqizuar vendimi i kësaj komune për kufizimin e shërbimeve të caktuara administrative për qytetarët e Komunës së Gjilanit, dhe duke qenë e vetëdijshme për pasojat e

këtyre vendimeve në statusin përfundimtar të kërkesave të parashtruara për shyrtim para saj, duke rikujtuar praktikën e vet gjyqësore në rastet e mëparshme identike (shih në mes të tjerash, rastin KI 11/09 të Gjykatës Kushtetuese të parashtruesit Tomë Krasniqi, të 7 qershorit 2011), Gjykata nuk e gjen të arsyeshme të vlerësojë përmbushjen e kritereve formale të plota të pranueshmërisë lidhur me rastet KI 58, KI 66 dhe KI 94/12.

45. Gjykata konsideron se nxjerrja e vendimeve nga ana e kuvendeve komunale për shfuqizimin e vendimeve paraprake për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara administrative në komunat respektive prej nga vijnë parashtruesit e kërkesave dhe me të cilat pretendohen shkeljet e të drejtave të njeriut, gjatë kohës sa këto kërkesa kanë qenë në shyrtim në Gjykatë, por gjithsesi para se Gjykata të marrë një vendim përfundimtar, tregon se pozita e parashtruesve të kërkesës ka ndryshuar në menyë të konsiderueshme dhe kërkesa tanimë nuk ka arsyetim, ndërsa qëllimi që kanë kërkuar të arrijnë, është arritur plotësisht. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka më merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje dhe një arsyetim të tillë Gjykata tashmë e ka shprehur qartë edhe në Vendimin KI 63/12 të 10 dhjetorit 2012 (shih Vendimin për heqje nga lista të Gjykatës Kushtetuese KI 63/12 të parashtrueses, deputetë znj. Alma Lama e 10 deputetëve të tjerë të 10 dhjetorit 2012).
46. Sidoqoftë, Gjykata e ka kompetencën dhe detyrën që ta adresojë këtë çështje posaçërisht duke pasur parasysh Rregulloren e vet të punës.
47. Në të vertetë, rregulli 32 (4) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese thotë se Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur konstaton se pretendimet janë pa objekt shqyrtimi apo nuk paraqesin më rast apo kontest. Ky rregull në pjesën relevante parashikon si në vijim:

#### Rregulli 32

#### Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

- (4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.
- (5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqjeje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.

48. Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas nenit 22 par 1 pika 2 të Kushtetutës së Kosovës zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, në pjesën relevante parashikon si në vijim:

Neni 37. Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundim se'
- a. kërkuuesi nuk e ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose
  - b. çështja është zgjidhur; ose
  - c. për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk e justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.
49. Si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk duhet të nxjerrë vendime për raste kur çështja nuk ekziston dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Gjykatat nuk merren me raste hipotetike apo akademike. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbajtjes gjyqësore.
50. Për më tepër, Gjykata tashmë ka përcaktuar (në rastin 11/09, Vendimi i 30 majit 2011, paragrafi 46 i parashtruesit Tomë Krasniqi) se "Koncepti i të qenit pa objekt shqyrtimi është koncept i mirënjohur ligjor. Mund të paraqitet në një rast kur një çështje abstrakte apo hipotetike paraqitet për t'u vendosur në Gjykatë. Ka baza të mira që një gjykatë të mos merret me situata hipotetike. Pa pasur një çështje të vërtetë, të menjëhershme apo konkrete për të cilën duhet të vendoset", Gjykata në fakt çfarëdo vendimi që do të merrte tani lidhur me meritat eventuale të kërkesave, nuk do të kishte një efekt praktik.
51. Duke marrë parasysh vendimet e kuvendeve komunale për shfuqizimin e vendimeve me të cilat qytetarët e komunave Mitrovicë, Gjilan dhe Viti kufizoheshin në gëzimin e shërbimeve administrative të caktuara në këto komuna, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani nuk kanë rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e këtyre vendimeve dhe çështja është faktikisht pa objekt shqyrtimi, andaj


## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, rregullin 32(4) të Rregullores së punës, njëzëri më 5 korrik 2013

### VENDOS

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën në pajtim me rregullin 32.4 të Rregullores së punës.
- II. Ky vendim u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, publikohet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani